




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në mbështetje të nenit 5, paragrafit 5.2, te nenit 16, të Ligjit nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 31/15 qershor 2008), të nenit 164, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare, Komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Stacioni i Autobuseve" Sh.A. në përbërje të Arben Kqira, Donjeta Dragusha dhe Amir Simnica, në mbledhjen e mbajtur më 11 Tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohen anëtarët e bordit të drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobuseve" SH.A. si vijon:
 1. Saranda Sadriu;
 2. Kujtim Raçi;
 3. Merita Surkishi;
 4. Enis Aliu.
2. Detyrat e anëtarëve të bordit të drejtorëve janë të përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike dhe Ligjin nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare.
3. Kompensimi i bordit të drejtorëve do të bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 20 të Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike dhe nenit 161 të Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare.
4. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara si në pikën 2 të këtij Vendimi, Bordi i drejtorëve i raporton Komisionit komunal të aksionarëve.
5. Të emëruarit si në pikën 1 të këtij Vendimi, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi janë të obliguar të bëjnë deklarinimin e pasurisë në pajtim me Ligjin nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Të emëruarve;
- Në dosje.

KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE:

- Arben Kqira
- Donjeta Dragusha
- Amir Simnica

